

## Ftesë për Aplikim(FA) Qeverisje lokale / çështje ligjore / politika publike

Helvetas Kosova fton kandidatët e interesuar që të aplikojnë për ofrimin shërbimeve në qeverisje lokale, çështje ligjore, politika publike si:

- **Konsulent i lartë ligjor**, dhe
- **Konsulent ligjor (junior)**

### 1. Përshkrimi i kontratës

Programi për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave (DEMOS), i zbatuar nga HELLETAS Sëiss Intercooperation (HELLETAS Kosova) ka objektivin e përgjithshëm: “Përmirësimi i performancës së komunave në qeverisje, menaxhim dhe shërbime duke kontribuar në rritjen e kënaqshmërisë së qytetarëve”. Janë tri rezultate të DEMOS III.

1) Granti i Performancës Komunale (GPK) është kredibil, efektiv dhe i institucionalizuar si dhe zbatohet plotësisht nga MAPL-ja me angazhim të mëtjeshëm publik; 2) Mbikëqyrja lokale nga organet përkatëse komunale është përmirësuar dhe mekanizmat e angazhimit të qytetarëve janë funksionalizuar duke përfshirë gjithnjë e më shumë shoqërinë civile dhe grupet e marginalizuara në vendimmarrjen komunale; 3) Korniza e politikave dhe ligjore është më e favorshme për qeverisjen lokale të decentralizuar dhe për financimin e komunave të bazuar në rregulla.

Në kuadër të rezultatit të parë dhe rezultatit të tretë, projekti DEMOS mbështet MAPL-në drejt institucionalizimit të GPK-së dhe politikave të tjera për mjedis më të favorshëm për qeverisjen e decentralizuar lokale dhe të financimit të bazuar në rregulla. Në kuadër të rezultatit të parë, projekti parasheh mbështetje teknike dhe të kapaciteteve për MAPL-në, ndërsa në kuadër të rezultatit të tretë projekti synon të rrisë kapacitetet e ministrisë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin më të mirë të kornizës ligjore. Për këtë qëllim, projekti parasheh ofrimin e mbështetjes ligjore për MAPL-në, përkatësisht Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm (ZSP) të MAPL-së, dhe ngritjen e kapaciteteve të departamentit ligjor në lidhje me ligjshmërinë e akteve komunale.

*Shërbimet e kërkuara dhe TeR për konsulent janë renditur në nenin 20 në këtë dokument.*

### 2. Afati kohorë

	DATA	ORA - CET
Shpallja	22 Mars 2023	-
Afati i fundit për dorëzimin e CV <sup>1</sup>	06 Prill 2023	14:00

### 3. Natyra e kontratës

Kontratë shërbimesh

### 4. Negociatat

Helvetas - Kosovë ruan të drejtën për të hyrë në negociata me të gjithë ose me një pjesë të ofertuesve të pranueshëm, në mënyrë që të ndryshojnë dhe/ose plotësojnë ofertat e tyre origjinale.

Negociatat mund zhvillohen në lidhje me aspektet teknike, financiare, ligjore dhe aspektet tjera të kontratës.

<sup>1</sup> Çdo aplikacion i dorëzuar pas këtij afati nuk do të merret parasysh.

**5. Pranueshmëria**

Konsulentët duhet të kenë përvojë në aktivitete në lidhje me TOR dhe të kenë përvojë të mëparshme në punën e konsulencës.

Nëpunësit civilë dhe personat e zgjedhur ose të emëruar në një funksion publik nuk kanë të drejtë të marrin pjesë si konsulentë në këtë konkurs. Kjo vlenë edhe për ish nëpunësit civilë dhe personat e zgjedhur ose të emëruar në një funksion publik të cilët ende nuk i kanë bërë 6 muaj qëkur janë larguar nga posti publik.

Ky konkurs është i hapur për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.

**6. Kostot për përgatitjen e ofertës**

Asnjë kosto e shkakuar nga ofertuesi, gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të dokumenteve të kerkuara, nuk rimburohet. Kostot e tilla bien nën përgjegjësinë e ofertuesit, duke përfshirë kostot e shaktuara gjatë procesit të negociimit dhe intervistimit.

**7. Nën-kontraktimi**

Nuk lejohen shërbimet e nën-kontraktimit tek një person tjetër juridik/fizik.

**8. Data e përkohshme e fillimit të kontratës**

Prill 2023

**9. Periudha fillestare e ekzekutimit të kontratës dhe zgjatja e mundshme e saj**

Shërbimet do të ofrohen gjatë periudhës Prill 2023 - Mars 2024, me mundësi vazhdimi, varësisht nga kërkesat dhe mundësitë buxhetore.

**Vlerësimi i CV**

Secila ofertë do të vlerësohet në përputhje me kriteret dhe peshimin e detajuar më poshtë. Kriteret për vlerësimin e shërbimeve do të shqyrtohen në përputhje me kërkesat e paraqitura në shtojca.

*E tërë procedura e vlerësimit është konfidenciale. Vendimet e Panelit Blerës (PB) janë kolektive dhe diskutimet e tij mbahen në seanca me dyer të mbyllura. Anëtarët e PB janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë. Raportet e vlerësimit dhe shënimet me shkrim janë vetëm për përdorim zyrtar dhe nuk mund t'i komunikohen ofertuesve ose ndonjë pale tjetër përveç Helvetas - Kosovë.*

**9.1 Kriteret e pranueshmërisë**

Kushtet/kërkesat	Dëshmitë e dokumentuara
1. Dokumentet e pranuar në kohë sipas pikës 2 -	N/A

Konsulentet që përmbushin kriteret e pranueshmërisë do të procedohen për vlerësim të mëtutjeshëm.

**10.2 Kriteret e vlerësimit të ofertave të pranueshme**

*Kriteret për vlerësimin e ofertës teknike*

Kushtet/kërkesat	Dëshmitë e dokumentuara
1. CV që përshkruan detyra të ngjashme bazuar në TeR	CV (me dëshmi të dokumentuara dhe të bashkangjitura). Dëshmi i dokumentuar i referohet diplomës, kontratave të punës ose provave të tjera të lëshuara nga një

	autoritet kontraktues. Vetëm dëshmitë të cilat janë relevante për fushat tematike të aplikimit do të merren parasysh.
--	---

CV-të e konsulentëve që kalojnë vlerësimin minimal teknik bazuar ne TeR (**Perputhje ne mes CVs dhe TeR** në të gjithë specifikimet teknike) do të procedohen për vlerësim të mëtutjeshëm.

*Kriteret për vlerësimin e ofertës financiare:*

Kushtet/kërkesat	Dëshmitë e dokumentuara
Ofertë financiare sipas udhëzimeve në PJESËN 2 të këtij dokumenti	Ofertë financiare në EURO ne muaj.

Peshimi i kriterëve për vlerësimin e ofertave teknike dhe financiare është si në vijim:

Kriteret	PO/JO
<b>Oferta teknike*</b>	<b>PO/JO</b>
<i>CV me</i> me dëshmi të rëndësishme dokumentare	Po/Jo
<b>Oferta financiare</b>	<b>Çmimi</b>
Ofertë financiare në EURO ne muaj.	E favorshme (po/Jo)

Pas vlerësimit të ofertave, ofertuesit të cilët kanë kaluar pjesën teknike dhe gjinden ne mesin e ofertuesëve me oferte financiare me te favorshme, do te ftohen për interviste. Kjo vlene për te dyja pozitat. Pas intervistave, do te behet përzgjedhja finale për te dyja pozitat.

Helvetas - Kosovë ruan të drejtën për të hyrë në negociata me të gjithë ose me një pjesë të konsulenteve të pranueshëm, në mënyrë që të ndryshojnë dhe/ose plotësojnë ofertat e tyre origjinale.

#### 10. Dorëzimi i ofertave

Konsulentet duhet të dorëzojnë oferta të veçanta për secilin pozite aplikimi. Ofertat duhet të dorëzohen me email , duke përdorur udhëzimet si me poshte.

Për pozitën **Zyrtar i Larte ligjor**

- CV me dëshmi te rëndësishme te dokumenteve dhe oferta financiare

Për pozitën **Zyrtar ligjor (junior)**

- CV me dëshmi te rëndësishme te dokumenteve dhe oferta financiare

CV dhe ofertat financiare duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme të postës elektronike: [procurement.kosovo@helvetas.org](mailto:procurement.kosovo@helvetas.org) dhe ne **titull të email-it duhet te shkruhet pozita per te cilën aplikoni**. Preferohet qe ofertat financiare te jene te mbrojtura me password.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të caktuar nuk do të shqyrtohen.

#### 12 Ndryshimi ose tërheqja e aplikacioneve

Konsulentet mund të ndryshojnë ose tërheqin ofertat e tyre me njoftim me shkrim para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Asnjë ofertë nuk mund të ndryshohet pas këtij afati.

Helvetas - Kosovë ruan pronësinë e të gjitha ofertave që nuk janë tërhequr. Rrjedhimisht, ofertuesit nuk kanë të drejtën e kthimit të ofertës tek ta.

### **13 Vlefshmëria e ofertave**

Ofertuesit janë të lidhur me ofertat e tyre për 90 ditë pas afatit për dorëzimin e ofertave. Në raste të jashtëzakonshme, para skadimit të periudhës së vlefshmërisë, Helvetas - Kosovë mund të kërkojë nga ofertuesit që të zgjasin periudhën e vlefshmërisë për një numri të caktuar ditësh, e cila nuk mund të kalojë 40 ditë.

### **14 Nënshkrimi i kontratës(-ave)**

Brenda 7 ditëve nga pranimi i kontratës tashmë të nënshkruar nga Helvetas - Kosovë, ofertuesi i përzgjedhur nënshkruan dhe shënon datën e kontratës. Mos-respektimi i kësaj kërkesë nga ofertuesi mund të përbëjë arsye për anulimin e vendimit për të dhënë kontratën. Në këtë rast, Helvetas - Kosovë mund t'ia japë tenderin një ofertuesi tjetër ose të anulojë procedurën e tenderit.

### **15 Kushtet e pagesave**

Pagesat për shërbimet e ofruara do të bëhen pas pranimit zyrtar të një raporti narrativ mujor të shoqëruar me një faturë përkatëse dhe/ose tabelë të orëve të realizuara të punës, miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së. Rastet e mos kryerjes së obligimeve dhe pasojat e tyre ligjore do të paraqiten veçmas në kontratë.

### **16 Kushtet e bashkëpunimit**

Helvetas-Kosovë nënshkruan një kontratë me Konsulentin fitues. Kontrata do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët.

### **17 Klauzolat e etikës/praktikat korruptive**

Ofertuesit që bëjnë deklaratat të rrejshme mund t'i nënshtrohen ndëshkimeve financiare që përfaqësojnë 10% të vlerës totale të urdhër blerjes/kontratës që i jepet. Kjo normë mund të rritet deri në 20% në rast të shkeljes së përsëritur.

Çdo përpjekje nga një kompani/organizatë për të marrë informata konfidenciale, për të hyrë në marrëveshje të paligjshme me konkurrentët ose për të ndikuar tek PP ose Helvetas-Kosovë gjatë procesit të shqyrtimit, sqarimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave do të çojë në refuzimin e ofertës së tyre dhe mund të rezultojë në ndëshkimet e përshkruara më sipër.

Kompanitë/organizatat do të refuzohen ose do t'u ndërpritet urdhër blerja/kontrata nëse del se dhënia ose ekzekutimi i një kontrate ka shkaktuar shpenzime të pazakonta komerciale. Shpenzimet e tilla të pazakonta komerciale janë komisionet e papërmendura në kontratën kryesore ose që nuk rrjedhin nga një kontratë e lidhur siç duhet që i referohet kontratës kryesore, komisionet që nuk paguhen në këmbim të ndonjë shërbimi aktual dhe legjitim, komisionet që transferohen tek një strehë tatimore, komisionet që i paguhen një pranuesi i cili nuk është i identifikuar qartë ose komisionet e paguara për një kompani/organizatë që ka çdo tipar të të qenit një kompani/organizatë guaskë.

Kontraktuesit që vërehen se kanë paguar shpenzime të pazakonta komerciale që lidhen me këtë projekt, do të jenë subjekt i ndërprerjes së kontratës dhe/ose do të ndëshkohen, varësisht nga serioziteti i fakteve të vërejtura.

Helvetas-Kosovë ruan të drejtën për të pezulluar ose anuluar procedurën, kur dëshmohet se

procedura e dhënies së kontratës ka qenë subjekt i gabimeve, parregullsi ose mashtrimeve substanciale. Nëse zbulohen gabime, parregullsi ose mashtrime substanciale pas dhënies së urdhër- blerjes/kontratës, Helvetas-Kosovë mund të përmbahet nga lidhja e urdhër blerjes/kontratës dhe/ose të ndërpresë urdhër blerjen/kontratën.

### 18 Gjuha operative

Të gjitha komunikimet me shkrim për këtë procedurë duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe angleze.

### 19 Informacione shtesë

Përmbyllja e tenderit dhe dhënia e kontratës i nënshtrohen disponueshmërisë së fondeve.

Helvetas-Kosovë ruan të drejtën për të anuluar këtë konkurs në çdo kohë, pa ndonjë detyrim për të. Po ashtu HELLETAS e ruan të drejtën që të refuzojë një apo të gjitha CV-të.

### 20. Termat e References per dy pozitat

## Termt e Referencës

Fusha e ekspertizës: **Qeverisje lokale / çështje ligjore / politika publike**

Pozita: **Konsulent i Lartë Ligjor**

Kohëzgjatja: **Prill 2023 – mars 2024**

### HISTORIKU

Programi për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave (DEMOS), i zbatuar nga HELLETAS Sëiss Intercooperation (HELLETAS Kosova) ka objektivin e përgjithshëm: “Përmirësimi i performancës së komunave në qeverisje, menaxhim dhe shërbime duke kontribuar në rritjen e kënaqshmërisë së qytetarëve”. Janë tri rezultate të DEMOS III.

1) Granti i Performancës Komunale (GPK) është kredibil, efektiv dhe i institucionalizuar si dhe zbatohet plotësisht nga MAPL-ja me angazhim të mëtjeshëm publik; 2) Mbikëqyrja lokale nga organet përkatëse komunale është përmirësuar dhe mekanizmat e angazhimit të qytetarëve janë funksionalizuar duke përfshirë gjithnjë e më shumë shoqërinë civile dhe grupet e marginalizuara në vendimmarrjen komunale; 3) Korniza e politikave dhe ligjore është më e favorshme për qeverisjen lokale të decentralizuar dhe për financimin e komunave të bazuar në rregulla.

Në kuadër të rezultatit të parë dhe rezultatit të tretë, projekti DEMOS mbështet MAPL-në drejt institucionalizimit të GPK-së dhe politikave të tjera për mjedis më të favorshëm për qeverisjen e decentralizuar lokale dhe të financimit të bazuar në rregulla. Në kuadër të rezultatit të parë, projekti parasheh mbështetje teknike dhe të kapaciteteve për MAPL-në, ndërsa në kuadër të rezultatit të tretë projekti synon të rrisë kapacitetet e ministrisë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin më të mirë të kornizës ligjore. Për këtë qëllim, projekti parasheh ofrimin e mbështetjes ligjore për MAPL-në, përkatësisht Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm (ZSP) të MAPL-së, dhe ngritjen e kapaciteteve të departamentit ligjor në lidhje me ligjshmërinë e akteve komunale.

**OBJEKTIVI**

Objektivi i këtij angazhimi është t'i ofrohet mbështetje e jashtme ligjore Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), përkatësisht Zyrës së Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm dhe Departamentit Ligjor, në kontekst të shqyrtimit, hartimit, analizimit dhe këshillimit për çështjet që kanë të bëjnë me legjisacionin primar dhe atë sekondar për qeverisjen lokale dhe decentralizimin, duke përfshirë ligjshmërinë e akteve komunale.

**DETYRAT DHE AKTIVITETET**

Konsulenti ligjor do t'i kryejë aktivitetet e mëposhtme, dhe jo vetëm, në bashkëpunim të ngushtë dhe nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm:

**Mbështetja për Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm në çështjet ligjore që kanë të bëjnë me mandatin e MAPL-së.**

- Ofron këshilla ligjore dhe mbështetje të vazhdueshme për çdo çështje që shfaqet e që mund të ndikojë në procesin e shqyrtimit të ligjshmërisë, në mënyrë që të sigurohet zgjidhje në kohë e çdo çështjeje ligjore të pazgjidhur;
- Ofron analiza të ndryshme ligjore në lidhje me dokumentet kryesore të MAPL-së, ligjet, aktet nënligjore dhe politikat e kërkuara nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, brenda fushës së përgjegjësisë së tij;
- Ofron këshilla juridike për zbatimin e legjisacionit për vetëqeverisjen lokale për të siguruar pajtueshmërinë e Ministrisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- Ndërmerr detyra të tjera të caktuara nga Sekretari i Përgjithshëm në lidhje me proceset e shqyrtimit të ligjshmërisë për komunat.

**Mbështetja për Departamentin Ligjor për përmirësimin e procesit të shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve komunale.**

- Mbështet Departamentin Ligjor për përmirësimin e procesit të shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve komunale në përputhje me afatet ligjore dhe ofron këshilla për Sekretarin e Përgjithshëm lidhur me këtë çështje;
- Mbështet departamentin për të zhvilluar sisteme dhe procese më efektive për monitorimin e komunave dhe për ngritjen e çështjeve kyçe për menaxhimin e Ministrisë;
- Mbështet departamentin për të zhvilluar procese më efektive për shqyrtimin ligjor të akteve komunale.
- Mbështet departamentin për të zhvilluar procese dhe mekanizma më efektiv për shqyrtimin ligjor të akteve komunale që ndërlidhet me GPK-në, përfshi mbledhjen dhe analizën e dhënave, sistemimin e të dhënave për procese the brendshme të MAPL-së dhe komunikimit me komunat, publikimin e të dhënave/raportit si dhe sigurimin e të dhënave sipas kërkesave të GPK-së.

Në kryerjen e detyrave konsulenti i lartë ligjor do të bashkëpunoj me konsulentin tjetër ligjor të DEMOS për MAPL.

**Profili i Konsulentit**

Konsulenti i lartë ligjor duhet t'i plotësojë kërkesat e mëposhtme për sa i përket kualifikimeve dhe shkathtësive si dhe përvojës profesionale.

**Kualifikimet dhe shkathtësitë**

- Master në fushën e juridikut ose kualifikime akademike ekuivalente;
- Të njohë rrjedhshëm gjuhën shqipe, njohuri të mirë gjuhës angleze. Njohja e gjuhës serbe e preferueshme;
- Specializimi akademik dhe/ose certifikimi profesional do të konsiderohet përparësi.

#### Përvoja e përgjithshme profesionale

- Së paku 8 vite pervojë pune në fushën ligjore;
- Përvojë pune me institucione publike (lokale apo qendrore);

#### Përvojë profesionale specifike

- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike;
- Njohuri lidhur me kornizën ligjore dhe rregulloreve të aplikueshme në fushat e përgjegjësisë së ministrisë;
- Njohuri me qeverisje lokale. E preferueshme njohja me proceset e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve komunale.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.

#### **Korniza kohore e angazhimit**

Ky angazhim pritët të zgjasë nga muaji **prill 2023 deri në mars 2024**.

#### **Raportimi**

Konsulenti do të ketë takime të rregullta me DEMOS për të diskutuar progresin në zbatim të detyrave. Aktivitetet dhe outputet për përmbushjen e çdo objekti të këtij angazhimi do të monitorohen dhe miratohen nga Zëvendësmanaxheri i Projektit.

## **Termt e Referencës**

Fusha e ekspertizës: **Qeverisje lokale / çështje ligjore / politika publike**

Pozita: **Konsulent ligjor (junior)**

Kohëzgjatja: **Prill 2023 – mars 2024**

#### **HISTORIKU**

Programi për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave (DEMOS), i zbatuar nga HELVETAS Säiss Intercooperation (HELVETAS Kosova) ka objektivin e përgjithshëm: “Përmirësimi i performancës së komunave në qeverisje, menaxhim dhe shërbime duke kontribuar në rritjen e kënaqshmërisë së qytetarëve”. Janë tri rezultate të DEMOS III.

1) Granti i Performancës Komunale (GPK) është kredibil, efektiv dhe i institucionalizuar si dhe zbatohet plotësisht nga MAPL-ja me angazhim të mëtjeshëm publik; 2) Mbikëqyrja lokale nga organet përkatëse komunale është përmirësuar dhe mekanizmat e angazhimit të qytetarëve janë funksionalizuar duke

përfshirë gjithnjë e më shumë shoqërinë civile dhe grupet e marginalizuara në vendimmarrjen komunale; 3) Korniza e politikave dhe ligjore është më e favorshme për qeverisjen lokale të decentralizuar dhe për financimin e komunave të bazuar në rregulla.

Në kuadër të rezultatit të parë dhe rezultatit të tretë, projekti DEMOS mbështet MAPL-në drejt institucionalizimit të GPK-së dhe politikave të tjera për mjedis më të favorshëm për qeverisjen e decentralizuar lokale dhe të financimit të bazuar në rregulla. Në kuadër të rezultatit të parë, projekti parasheh mbështetje teknike dhe të kapaciteteve për MAPL-në, ndërsa në kuadër të rezultatit të tretë projekti synon të rrisë kapacitetet e ministrisë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin më të mirë të kornizës ligjore. Për këtë qëllim, projekti parasheh ofrimin e mbështetjes ligjore për MAPL-në, përkatësisht Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm (ZSP) të MAPL-së, dhe ngritjen e kapaciteteve të departamentit ligjor në lidhje me ligjshmërinë e akteve komunale.

## **OBJEKTIVI**

Objektivi i këtij angazhimi është t'i ofrohet mbështetje e jashtme ligjore Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), përkatësisht Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, në kontekst të shqyrtimit, hartimit, analizimit dhe këshillimit për çështjet që kanë të bëjnë me legjislacionin primar dhe atë sekondar për qeverisjen lokale dhe decentralizimin, duke përfshirë ligjshmërinë e akteve komunale.

## **DETYRAT DHE AKTIVITETET**

Konsulenti ligjor do t'i kryejë aktivitetet e mëposhtme, dhe jo vetëm, në bashkëpunim të ngushtë dhe nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm:

### **Mbështetja për Sekretarin e Përgjithshëm në çështjet ligjore që kanë të bëjnë me mandatin e MAPL-së.**

- Mbështet Sekretarin e Përgjithshëm dhe MAPL-në për çështjet ligjore që kanë të bëjnë me mandatin e MAPL-së;
- Mbështet Konsulentin e Lartë Ligjor në kuadër të zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm së për çdo çështje që shfaqet e që mund të ndikojë në procesin e shqyrtimit të ligjshmërisë;
- Kontribuon në analizat ligjore me kërkesë të zyrës së ZSP-së dhe në bashkërendim me Konsulentin e Lartë Ligjor.
- Jep mbështetje grupeve punuese të ministrisë në aspektet juridike dhe sipas kërkesës së ZSP-së

### **Të përgjithshme**

- Merr pjesë, sipas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm, në grupet përkatëse punuese të Ministrisë dhe/ose grupet tematike, që lidhen me këtë angazhim;
- Ofron ndihmë juridike për aktet nënligjore, rishikimin e legjislacionit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare si dhe ofron opinion ligjor dhe këshilla për zbatimin e legjislacionit;
- Ndërmerr detyra të tjera të caktuara nga Sekretari i Përgjithshëm në lidhje me proceset e shqyrtimit të ligjshmërisë për komunat.

## **Profili i Konsulentit**

Konsulenti ligjor duhet t'i plotësojë kërkesat e mëposhtme për sa i përket kualifikimeve dhe shkathtësisë si dhe përvojës profesionale.

### **Kualifikimet dhe shkathtësitë**

- Diplomë universitare, fakulteti juridik ose kualifikime akademike ekuivalente;
- Të njohë rrjedhshëm gjuhën shqipe, njohuri të mirë gjuhës angleze. Njohja e gjuhës serbe e preferueshme;

- Specializimi akademik dhe/ose certifikimi profesional do të konsiderohet përparësi.

#### Përvoja e përgjithshme profesionale

- Së paku 4 vite pervojë pune në fushën ligjore;
- E preferueshme përvojë pune me institucione publike (lokale dhe qendrore);

#### Përvojë profesionale specifike

- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike;
- Njohuri lidhur me kornizën ligjore dhe të rregulloreve të aplikueshme në fushat e përgjegjësisë së ministrisë;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.

#### **Korniza kohore e angazhimit**

Ky angazhim pritet të zgjasë nga muaji **prill 2023 deri në mars 2024**.

#### **Raportimi**

Konsulenti do të ketë takime të rregullta me DEMOS për të diskutuar progresin në zbatim të detyrave. Aktivitetet dhe outputet për përmbushjen e çdo objektivi të këtij angazhimi do të monitorohen dhe miratohen nga Zëvendësmenaxheri i Projektit.

**PJESA 2 - OFERTA FINANCIARE****Oferta financiare**

Konsulenti duhet ta paraqes oferten financiare ne neto dhe Helvetas është përgjegjës për të gjitha tarifat dhe taksat tjera në përputhje me Ligjet e Republikës së Kosovës<sup>2</sup>.

<b>Artikujt – specifikimet</b>	<b>Njesia</b>	<b>Cmimi Neto</b>
Pagesa Mujore (Neto)	<i>1 Muaj</i>	

Nënshkruar në emër të ofertuesit

<b>Emri</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Data</b>	

---

<sup>2</sup> Ne rast se Konsulenti posedon numer fiskal obligohet që t'i paguaj të gjitha obligimet e parapara me Ligjet e Republikës së Kosovës